29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.



### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshhtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejtë të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejtë që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

#### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

##### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:



- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. PAGESA E VËRTETUAR nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi «a» më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Supo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 615-24-7389-5-2-1/C1050

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 19,361.50€ me vlefshmëri prej duke filluar nga data e nënshkrimit deri më 29.12.2024
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik e që është 90 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është</p>

		10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>Do të caktohet nga ZKA brenda tre ditësh</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>N/A</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>N/A</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë,
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Komuna e Podujevës</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë, ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.</p>



**PROJEKTI: RENOVIMI I SHKOLLËS SË VJETËR NË FSHATIN KËRPIMBH - PODUJEVË**

**PARAMASA ME PARALLOGARI**

1 PUNËT E PËRGATITORE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Instalimi i zyrës së përkohshme në punishtë sipas rregullave dhe kërkesave për mesazhimin e punëve ndërtimeve.	copë	1.00	42.40	42.40 €
2	Shpërndarimi i punishtës sipas standardeve të ndërtimit hyrje daljeve në kantier, duke përfshirë edhe montimin e tabelës informuese me emrin e projektit, investitorit, punëkryesit etj.	kompjlet	1.00	42.40	42.40 €
3	Instalimi i përkohshëm i rrjetit elektrik, ujësjellës, kanalizimit dhe ndriçimit i kantierit.	kompjlet	1.00	42.40	42.40 €
				<b>shifototali</b>	<b>127.20 €</b>

2 PUNËT E DEMOLIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Demontimi me tufëzë i tregullave ekzistuese të grumbullohen dhe të përdoren të pa dëmtuara në vendin ku e cakton investitori. Llogaria është në m <sup>2</sup> të bazës horizontale të kullit.	m <sup>2</sup>	459.81	0.90	357.87 €
2	Demontimi i tërësisë së konstruksionit të kullit nga dhuratë me të gjitha elementet përfshirë, çelëqve horizontale dhe vertikale, rrafshet ekzistues, detyrues, këmbëzve ekzistues të detyruesve dhe detyrues etj. Barta në deponë ku e cakton investitori. Llogaria është në m <sup>2</sup> të bazës horizontale të kullit.	m <sup>2</sup>	459.81	4.00	1,839.24 €
3	Demontimi i platformë ekzistues me të gjitha shtresat, si dhe transporti dhe barta e materialit në deponë ku e cakton investitori. Këtu hynë edhe demontimi i tullave të cilat janë të dolura si të shkallëzara në pjesën e sipërme të murit, përkatësisht të tërësisë rrafshet (paviment) i murit nëhi të cilat do të vendoset tani në betonarmesë.	m <sup>2</sup>	459.81	1.00	459.81 €
4	Demontimi i dyshemesve ekzistues duke përfshirë edhe dyshemesë e bodrumit me të gjitha shtresat (në një thellësi deri 30 cm), si dhe transporti dhe barta e materialit në deponë ku e cakton investitori.	m <sup>2</sup>	458.21	0.40	183.28 €
				<b>shifototali</b>	<b>2,650.36 €</b>

3 PUNËT E ZHAVORIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Mbushje e hapësirave të dyshemesve me zhoror nga gur i thyer me granulometri 0-31mm me trashësi deri në 20mm në shtresë të njëzëshme.	m <sup>3</sup>	91.61	10.00	916.10 €
				<b>shifototali</b>	<b>916.10 €</b>

4 PUNËT E BETONIT DHE BETONARMESË					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Furnimi, transporti me beton C-20/20 (M20-20) dhe punimi i shtresës rrafshuese me 10-15 cm mbi zavorin e ngjeshur si shtresë rrafshuese për punët e armaturës, sipas detajeve për shkakutim. Në çmim të përfshihet edhe nivelimi, rrafshimi dhe përpunimi i tësës shtrese nga betoni i dëbët.	m <sup>2</sup>	22.91	45.00	1,030.95 €
2	Furnimi, transporti, kalupimi dhe betonimi i pllakës së dyshemesë të përbërës dhe bodrumit me beton të përbërës nga betoni, t=12cm. Betoni C25/20.	m <sup>2</sup>	54.98	75.00	4,123.50 €
3	Furnimi, transporti, kalupimi dhe betonimi i pllakës (mashtat) dhe shtresat përgjatë perimetrit t=20cm, me betoni të shtesës C 25/20.	m <sup>2</sup>	103.80	75.00	7,774.50 €
4	Furnimi, transporti, kalupimi dhe betonimi i shtresës së betonit të përbërës me pllakën e mashtat dhe me shtresat e betonit të shtesës së betonit të shtesës C 25/20. (përfshirë të gjitha punët e përbërës edhe në ditë të pas demontimit të kullit dhe rrafshet të tullave ekzistues). Të bëhet armaturimi i tij edhe me armaturë konstruktive me must elëzues.	m <sup>2</sup>	30.82	77.00	2,373.34 €
				<b>shifototali</b>	<b>14,213.31 €</b>

5 PUNËT ARMIRUESE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Çeliku për armaturë do të jetë i brishtëuar përvojë sipë e sipë sipas indikacione tjara nga organi mbikëqës. Çeliku për armaturë do të aplikohet në përpunje të plotë me normat ENV 10080 si dhe të pozicion me karakteristika që vijnë. Vlera karakteristike e kullit të njëzës (të cilat strengti karakteristike vlerë) fyk=500 N/mm <sup>2</sup> . Mashtat e diametri të përpunimit me vlerat nominale sipas ENV 10080. Furnimi, preja, lakimi dhe montimi i shtresës së armaturës në të cilat sipas funksionit të përdorimit të kullit do të bëhet edhe si dhe të vendoset në vendet e duhura. Çeliku për armaturë do të aplikohet në përpunje të plotë me normat ENV 10080. Vlera e karakteristik (të cilat strengti) E = 500 N/mm <sup>2</sup> . Furnimi, preja, lakimi dhe montimi i armaturës në të cilat sipas funksionit të përdorimit të kullit do të bëhet edhe si dhe të vendoset në vendet e duhura. Diametri i shtrësve që do të përdoren është nga 10mm - 12 mm. Në çmim të llogarit edhe të gjitha montimet për të cilat të armaturës dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë punim.	kg	15778.0	0.70	11044.60 €
				<b>shifototali</b>	<b>11044.60 €</b>

6 PUNËT E IZOLIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	Furnimi, transporti, punimi dhe vendosja e hidroizolimit horizontal me lartësi të bollë (bituli) dhe në shtresë të fundit të 4mm mbi pllakën e dyshemesë të përbërës dhe bodrumit.	m <sup>2</sup>	438.21	5.00	2,191.05 €
2	Furnimi, transporti dhe punimi i hidroizolimit horizontal në dyshemesë e njëzës së shtresës, nënjes rëndore dhe murit të lavamanit me kalmin e të njëzës përgjatë murit vertikalit t=80cm me të gjitha shtresat si në pozicionet përfaqë. Zona e fundit e shtresës	m <sup>2</sup>	58.20	6.80	395.76 €
				<b>shifototali</b>	<b>2,586.81 €</b>




7 PUNËT E MURATIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve ndarëse të brendshme me blloqe argjilë të pjekur 20x25x20cm, në llaçin vazhdues 1:2:6, C25/30, h=10cm, në kallupe dhe me përdorimin e platformës punuese.	m <sup>2</sup>	8.00	55.10	330.60
1	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve të jashtme me tulla të vegjra të pjekur me dimensionet standarde, në llaçin vazhdues 1:2:6, C25/30, në kallupe dhe me përdorimin e platformës punuese. Përdoret në plotësimin e murave të dëmbuara.	m <sup>2</sup>	3.00	72.00	216.00
nëntotali					546.60

8 PUNËT E SUVATIMIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transportimi dhe suvatimi i mureve dhe platformeve me llaç vazhdues në dy shtresa me sipërfaqje të mëprishura me bazë, në çmim llogaritur edhe llajmet metalike që vendosen në kënde. Foraprazhëz përvarja e suvatimit është e përfshirë.	m <sup>2</sup>	1573.19	9.00	14158.71
nëntotali					14158.71

9 PUNËT E GLEJIT DHE NGJYROSJES					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti i materialit dhe glejtimi i murt dhe gletimit deri në dy shtresa përkatëse deri në përfundimin e sipërfaqes për ankimin e ngjyrosjes.	m <sup>2</sup>	1573.19	3.40	5,348.85
2	Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja me ngjyrë akrizë për mure dhe platforme në dy shtresa, taji dhe ngjyrosja e këmbës së investitorit dhe në konsolidim me projektuesin, prodhuesit TUB, Kraft, Helux, Bafra, çdo të kategorizimit të njëjtë. Foraprazhëz ngjyrosja me ngjyrë bazë. Llogaritur të bëhet për m <sup>2</sup> të sipërfaqes së punuar. Të llogaritur edhe ngjyrosja ekologjike në pjesën e poshtme të mureve (h=1.2) në të gjitha këmbët, në këmbët në ankimin e bazës.	m <sup>2</sup>	1573.19	1.50	2,359.79
nëntotali					7,708.64

10 PUNËT E DRURIT					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i konstruksionit të drurit për kulm nga lëndë shtesore e drurit të kategorisë së I-së me tërë materialin e nevojshëm si: trajt, shtyllat, mbajtës 10/12 (cm), dërrazat të cilat janë 1.2 cm, folje drurive, kontrastelat, listelat, të gjitha pjesët përjetëse për ankimin, shtangim si dhe me ankimimin në konstruksion në rreze me detaje sipas projektit. Llogaritur për m <sup>2</sup> të sipërfaqes horizontale të kulmit.	m <sup>2</sup>	518.34	16.00	8293.44
nëntotali					8293.44

11 PUNËT E MBULESËS					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti dhe mbulimi i kulmit me tregulla "Fendoch" me të gjitha pjesët e nevojshme, të llogaritur edhe kullerantë (papunët standarde) me tërë materialin e nevojshëm për montimin. Llogaritur komplet për m <sup>2</sup> të sipërfaqes së kulmit të kulmit.	m <sup>2</sup>	647.92	13.60	8811.71
nëntotali					8811.71





12 PUNËT E ZORRËHTARISË					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnimi, transporti dhe montimi i dritareve - hapësirave për mbijet nga materiali PVC me nuancë dhe strukturë euri - Hapja e dritareve sipas skemës së zorrëhtarisë . Dritaret janë të pajisura me sham termopan (12+4 mm) . Profilët me trashësi 7.6cm - 8.0cm				
	Dritare dim: 150/230 (cm)	copë	13.00	270.00	4350.00
	Dritare dim: 120/200 (cm)	copë	6.00	300.00	1800.00
	Dritare dim: 100/200 (cm)	copë	8.00	240.00	1920.00
2	Furnimi, transporti dhe montimi i detyrëve të brendshme nga prodhuesit "HORMAN", "NOVOFERM", apo i ngjashëm nga flatës e metalit i plastifikuar. Krahët e derës të jeshë me mbishitjet e metalit 1+0,8mm të mbushura me termopolim Ppopen, trashëcia e krahut të derës 1+4cm. Shitkot/kornizat të jeshë metalike 1+2,2mm, mveshje e murit (10-50 cm) dhe turësi sipas dim. në projekt duke përfshirë ndriqimin brenda kamblës si dhe të pajisura me garnë perimetrike, esantasha të gjvë dhe , mekanizmi mbijetës dhe dorëzë inox; me izolim akustik të akorduar sipas (DIN EN ISO 140-3 (p220)). Shitkot/kornizat dhe panell i derës me nuanco RAL: 9007. Dyrët në lartësi të hapjes finale 210cm. Të gjitha dyertë dhe materialet e tyre duhet të jenë me standarde të kualitetit sipas ISO 9001. Logaritet në copë.				
	Dyertë dim: 110/200 (cm)	copë	10.00	251.24	2512.40
	Dyertë dim: 90/200 (cm)	copë	1.00	250.00	250.00
	Dyertë dim: 80/200 (cm)	copë	1.00	250.00	250.00
3	Furnimi, transporti dhe montimi i detyrëve të jashtme nga materiali PVC me nuancë dhe strukturë euri . Hapja e detyrëve sipas skemës së zorrëhtarisë . Dyrët janë të pajisura me sham termopan (12+4 mm) , rrethës me trashësi 7.6cm - 8.0cm				
	Dyertë dim: 100/200 (cm) (me mbijetësi)	copë	2.00	630.00	1260.00
	Dyertë dim: 90/200 (cm) (metalike)	copë	1.00	200.00	200.00
	Dyertë dim: 100/200 (cm) (me mbijetësi)	copë	2.00	400.00	800.00
				<b>mbetotali</b>	<b>13912.40</b>

13 PUNËT E LLAMARINËS					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnimi, transportimi dhe montimi i blloqve vertikale Ø120mm me të gjitha elementet përparësia prej llamarinës së plastifikuar, trashësi të jeshë 10 mm dhe në logaritë e pozicionit të përfunduar së bashku me brytat dhe buntarët. Nuanca e çelikut AK.	m <sup>2</sup>	22.00	2.00	304.00
	Furnimi, transporti dhe montimi i llamarinës së plastifikuar në llogaritë me gjatësi të brendshme .	m <sup>2</sup>	20.00	8.00	160.00
3	Furnimi, transportimi dhe montimi i llamarinës së plastifikuar me të gjitha elementet përparësia prej llamarinës së plastifikuar . Nuanca e çelikut AK.	m <sup>2</sup>	120.00	2.00	810.00
4	Furnimi, transportimi dhe montimi i llamarinës së plastifikuar me të gjitha elementet , si dhe me vendosjen e elementit përfundimtar sipër çelikut . Të logaritet paraprirësisht edhe përfundimi dhe përfundimi i tyre me elemente adekuata nëse janë të detyrues . apo edhe të bllokuar .	m <sup>2</sup>	8.00	46.60	372.80
				<b>mbetotali</b>	<b>1876.80</b>

14 PUNËT E RIVULIZIMIT (ESTRIPIOT)					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnimi, transporti me material si dhe punimi i shtrësës rrafshore nga betoni gjvësi i terur me fibra në dytësore me trashësi min. 5 cm për mbrojtjen e termopolimit , pozicioni përfundimtar foljen PVC-08 dhe termopolimin shtrësor 1+3+2cm .	m <sup>2</sup>	458.73	10.17	4,660.60 €
2	Furnimi, transporti me material si dhe punimi i shtrësës rrafshore nga betoni gjvësi i terur me fibra në dytësore përfundimtare me trashësi min. 5 cm për mbrojtjen e termopolimit , pozicioni përfundimtar foljen e PVC-08 dhe termopolimin shtrësor 1+3+2cm .	m <sup>2</sup>	518.34	7.00	3,628.38 €
				<b>mbetotali</b>	<b>8,288.98 €</b>



15 PUNËT E DYSHEMËSE					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave të dyshemesë (për toallor dhe këmbësorë) nga porcelani klasi I parë, dy herë të pjekura, fortësia min. 50N/mm <sup>2</sup> , rezistenca ndaj abrazionit, ngricave, acideve të përbush kushtet, absorbimi i ujit duhet të jetë më e ulët se 0.5%. Vendoja e pllakave duhet të bëhet konform standardeve. Në çmim duhet të përfshihen edhe këndoret e aluminit, ngjësia dhe të gjitha punët tjera të përfshira për të siguruar produktin final.	m <sup>2</sup>	22.19	18.85	418.81
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave të murit nga porcelani klasi I parë, dy herë të pjekura, fortësia min. 50N/mm <sup>2</sup> , rezistenca ndaj abrazionit, ngricave, acideve të përbush kushtet, absorbimi i ujit duhet të jetë më e ulët se 0.5%. Vendoja e pllakave duhet të bëhet konform standardeve. Në çmim duhet të përfshihen edhe këndoret e aluminit, ngjësia dhe të gjitha punët tjera të nevojshme për të siguruar produktin final.	m <sup>2</sup>	94.08	18.64	1753.65
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave nga graniti artificial - gres porcelan me trashësi 1cm për dyshemesë e ballit, erëmbrojtës dhe hapësirë ku është planifikuar të jetë kuzhina dhe detyra e kuzhinës si dhe të hapësirës së ruanjes qendrore dhe dyshemesë e bodrumit. Në log. hyjnë të gjitha shtrësat përçelësive, si dhe çelësi me lartësi 80 cm me lëvizje përfundore nga PVC-ja. Ngjyrit dhe dizajni e zgjedh imazhit.	m <sup>2</sup>	209.60	18.00	3772.80
4	Furnizimi me material dhe vendoja e lëvizësve me trashësi 12mm të instaluar nga lagësia dhe abrazionit. ACS HDI me peshë jo më të vogël se (800-950)kg/m <sup>2</sup> tarrile për dysheme me ngjyritje. Përzgjedhja e tij (lëvizje dhe ngjyritje) e bëjë AK. Në çmim përfshihen edhe listelat këndore.	m <sup>2</sup>	226.49	13.56	3071.20
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i granitit natyral jo rrezhues me trashësi 2cm për shkallët turrë (edhe balçoret janë logjistike në mënyrë dhe rrepa në objektin, me të gjitha shtrësat. Në këtë pozicion të logarit edhe nivellimi i shkallëve dhe gurimoret të tyre me materiale adheziv. Ituanon e çelësit AK.	m <sup>2</sup>	42.50	49.15	2098.88
përbetimi					11,100.34 €

16 PUNËT E NDRYSHME					
Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Shuma
